



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 02

Datë: 08. 01. 2021. Ora: 14:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Valdete Daka, kryetare e KQZ - së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Alim Rama, Eshref Vishi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Artan Asllani, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;
2. Aktivitetet e ZRPPC-së
3. Raport i Këshillave të KQZ-së:

-Këshilli për Operacione Zgjedhore

-Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit për konfirmimin e të dhënave nga baza e shënimeve të departamentit të pensioneve në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale,

- Shqyrtimi dhe miratimi i Formularëve për Aplikim për Votim Jashtë Kosovës,

-Shqyrtimi dhe miratimi i Strategjisë së Informimit Publik për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës,

-Propozim për formimin e Këshillit Mbikëqyrës për Informim Publik

-Shqyrtimi dhe miratimi i Analizës dhe Raportit nga të gjeturat për identifikimin e mangësive dhe sfidave të trajnimit gjatë proceseve zgjedhore 2009-2019,

-Shqyrtimi dhe i analizës dhe vlerësimit gjithëpërfshirës i Qendrave të Votimit

-Shqyrtimi i Planit të veprimit të KQZ-së për adresimin e rekomandimeve nga Misioni i Vëzhgueseve të Zgjedhjeve i Bashkimit Evropian nga zgjedhjet e vitit 2019

4. Të ndryshme.

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:

Valdete Daka: E kemi një rend dite, por mesa e di unë Këshilli për Operacine Zgjedhore ka edhe një çështje e cila është diskutuar në këshill e ajo është validiteti i dokumentiteve të Unmikut. Po e fusim edhe atë në rend dite edhe po procedojmë drejt për se drejti. Atëherë kush është për këtë rend dite me këtë shtesë? Faleminderit. Atëherë fillojmë me aktivitetet e ZRPP-s, urdhëro Yll.

2. Aktivitetet e ZRPPC-së

Yll Buleshkaj: Faleminderit shumë kryetare. Vetëm sa për informatë është marr dje nga KQZ-ja prokurorimi i planit operacional. Kemi filluar ti kryejmë detyrat tona sepse zyra i ka aktivitet e para që ndërliidhen me zgjedhjet e parakohshme për kuvendin e Kosovës. Jemi duke i vendosur formularët së bashku me afatet kohore në ueb-faqe. Ndërsa sot po ashtu do të shkoj në të gjitha subjektet politike për koalicione dhe për dokumentacionin që duhet të kenë ata për certifikim i cili është i njëjtë si herët e kaluara por praktik e kemi si herët e kaluara ta rikujtojmë sepse është një listë mjaft e gjatë e dokumentave. Në të njëjtën kohë ne jemi duke pritur edhe disa raporte financiare të fushatës për zgjedhjet në komunën e Podujevës dhe Mitrovicës së Veriut. E afati i fundit për këtë është 12 janari, do të thotë javën e ardhshme. Po ashtu jemi duke e shqyrtuar siç thash dje edhe dy aplikacione për regjistrim të partive politike, kemi pasur interes që të dorëzohen edhe aplikacione, ne si praktik e pezullojmë punën për regjistrim të partive të reja posa të shpallen zgjedhjet. Nuk kam diçka më shumë përveçse nëse keni ndonjë pyetje. Faleminderit shumë.

Valdete Daka: A ka dikush pyetje për drejtorin? Nëse jo vazhdojmë me këshillin për operacione zgjedhore, urdhëro Alim.

3. Raport i Këshillave të KQZ-së:

Këshilli për Operacione Zgjedhore

Alim Rama: Faleminderit. Atëherë duke marr parasysht edhe zgjedhjet e Podujevës, edhe dokumentet e Unmikut që nuk Pranohen që ju ka skaduar validiteti. Ndërsa personat që kanë dokumente të Unmikut dhe ndodhen në regjistrin civil krijojnë një pasaktësi në listën e votuesve. Këshilli për operacione zgjedhore

në mënyrë unanime rekomandon KQZ-n për aprovim që të gjithë personat që kanë dokumente të Unmikut e të cilat ndodhen në listën e votuesve të largohen. Lista votuese preliminare që publikohet të mos përfshij personat që kanë dokumente të Unmikut. Preliminare në fillim që në cofëtës përvjelë ndonjë gabim me pas mundësi të korrigjohet.

Valdete Daka: Faleminderit. Siç e dini dokumentet e Unmikut tashmë nuk janë të vlefshme që nga viti 2013 nuk kanë validitet dhe megjithatë ndodhen në listën e votuesve dhe siç tha edhe Alimi, kontribuojnë në pasaktësinë e listës votuese dhe në keqpërdorime eventuale. Dhe plotësisht me të drejt Këshilli për Operacione Zgjedhore rekomandon KQZ-n që të kërkoj nga agjensioni për regjistrin civil që këta persona jo të largohen nga lista sepse ne nuk mundemi ti largojmë por, të pezullohen dhe neve mos të na vije ekstrakti me emra të tyre. Sepse pastaj, çka bënë agjensioni është diçka tjetër ne nuk mundmi ti largojmë edhe me dashtë. Por agjensioni mundet përkohësisht ti pezulloj këta persona dhe mos të figurojnë në ekstraktin të cilin ne e marrim si KQZ.

Ne, tha më tej znj. Daka, përfundimisht nuk mundemi ti largojmë nga lista përfundimisht por ARC-ja mundet ti pezulloj dhe mos ti dërgoj tek ne si votues. Gjithsesi të gjithë ata qytetarë që kanë këto dokumente kanë mundësi që në agjencion të shkojnë dhe të kërkojnë ta ndryshojnë dokumentin ti marrin dokumentet e identifikimit të Kosovës. Atëherë nëse ka dikush pyetje apo vërejtje apo ndonjë çështje lidhur me këtë temë urdhëroni, nëse jo. Kush është për këtë rekomandim?

1.Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit për konfirmimin e të dhënave nga baza e shënimeve të departamentit të pensioneve në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale:

Alim Rama: Faleminderit. Këshilli për Operacione Zgjedhore e ka shqyrtuar raportin i cili ka të bëjë me konfirmimin e të dhënave nga baza e shënimeve nga departamenti të pensionistëve të punës dhe mërquinjës sociale. Siç e dini KQZ-ja e ka trajtuar listën e personave të vdekur gjatë vitit të kaluar. Ku ka pasur një konstatim ku aty ka pasur diku 23.000 persona. Por ndërkohë brenda vitit të kaluar ka konfirmuar vetëm 11.000 e diçka nga ta ndërsa tash rekomandon që ata që janë të konfirmuar të largohen nga lista e votimit po ashtu.

Valdete Daka: Faleminderit. Pra edhe një numër i konsiderueshëm i personave tashmë të ndjerë do të largohen nga lista votuese. Atëherë nëse nuk kemi ndonjë pyetje. Kush është për rekomandimin e KOZ-it?

Anëtarët e KQZ-së miratuan raportin për konfirmimin e të dhënave nga baza e shënimeve të departamentit të pensioneve në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

2.Shqyrtimi dhe miratimi i Formularëve për Aplikim për Votim Jashtë Kosovës,

Alim Rama: Po ashtu, KOZ-i sot në mbledhjen e rregullt e ka shqyrtuar formularët për aplikim për votim jashtë Kosovës me synim të thjeshtimit të aplikimit të votuesve jashtë Kosovës. Fatkeqësisht KOZ-i nuk ka qenë në mënyrë unanime që të shkoj edhe një hap tutje që ta bëjë këtë aplikim me online sepse për mua aplikimi aplikimi për jashtë votuesit jashtë Kosovës momentalisht bëhet vetëm duke e plotësuar formularin në mënyrë manuale. Një hap më tutje kishte për të qenë që ky formular me qenë edhe ne

aplikacionin online të cilën e ka një KQZ-ja por fatkeqësisht ajo nuk ka kaluar në KOZ. Por KOZ-i ka kaluar disa modifikime të thjeshta të formularit i cili sado pak ja thjeshton qytetarit me plotësuar këtë formular.

Valdete Daka: Faleminderit. Atëherë e kemi formularin për regjistrim dhe aplikim për votim jashtë Kosovës i cili i ka dy faqe dhe e keni shqyrtuar në KOZ dhe i njëjti tashmë është jetësuar aq sa ka mundur. Kush është për aprovimin e këtij formulari? Po urdhëro.

Sami Kurteshi: Faleminderit. Unë i kam parë dy formularët, unë i lexova në fillim dhe sinqerisht nuk e kuptova drejt por është përdor ky formular nuk është hera e par që po përdoret. Ky formular duhet të jetë për personat që kanë një prind apo dy prind, jetojnë jashtë Kosovës kanë prindërit nga Kosova apo cili është karakteri i këtij formulari. Çka duhet me specifiku këtu. Unë vetëm po e bëj pyetjen formulari i regjistrimit dhe aplikimit jashtë Kosovës, unë e kuptova që ky formular ka të bëjë me fëmijët që kanë lindur atje.

Valdete Daka: Por që kanë dokumente të Republikës së Kosovës. Pra vetëm ata persona që janë në listë votuese dhe që posedojnë dokumentin e Republikës së Kosovës, pra letërnjoftimin munden të aplikojnë.

Alim Rama: Formulari i regjistrimit ka të bëjë me personat të cilët nuk kanë dokumente të Kosovës por kanë një prind ose në një mënyrë tjetër e gëzojnë nënshtetësinë e Kosovës. Gëzojnë të drejtën të votojnë sipas ligjit. Ndërsa formulari i aplikimit ka të bëjë me personat që janë në regjistrin civil të Kosovës e që jetojnë jashtë Kosovës.

Valdete Daka: Ata që i plotësojnë kushtet për të qenë shtetas dhe ata që janë shtetas. Kush është për aprovimin e këtij formulari? Faleminderit. Kemi edhe formularin tjetër e ai është formulari për aplikim për votim jashtë Kosovës.

Sami Kurteshi: Është formulari i njëjtë unë kam dy çështje që duhet mi ngrit. Një, është që nuk ka nevojë për dy numra të telefonit. Unë nuk e kisha këto që i kam marr nga posta. Unë tash po e shoh faleminderit për këtë edhe kërkesa ime tjetër ka të bëjë me të njëjtën vërejtja që është në fund, formulari juaj së bashku me dokumentet e kopjuara. A ka mundësi këtë ta qesim në fillim që njerëzit ta shohin t`ju bie menjëherë në sy sepse ka mundësi e mbush formularin dhe nuk e sheh apo mendoni se nuk ka ndonjë rëndësi kjo vërejtja në fund.

Valdete Daka: Unë nuk besoj që ka rëndësi sepse kur të vije tek nënshkrimi këtu në fund pra e nënshkruan këtë dhe pa tjetër që e lexon edhe këtë, a është poshtë apo lart nuk besoj që luan rol. E kemi këtu edhe zëdhënës kryeshefin i cili po thotë se është në rregull dhe se kështu ka funksionuar në çdo palë zgjedhje. Atëherë kush është për këtë formular ashtu siç, është?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan Formularët për Aplikim për Votim Jashtë Kosovës

3.Shqyrtimi dhe miratimi i Strategjisë së Informimit Publik për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe formimin e Këshillit Mbikëqyrës për Informim Publik:

Alim Rama: Po ashtu në Këshill për Operacione Zgjedhore, KOZ-i e ka trajtuar strategjinë për informimin publik për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, strategjia është punuar në mënyrë profesionale dhe i ka paraparë të gjitha mënyrat se si ka për ti bërë fushatën KQZ-ja për këto

zgjedhje. Ndërkohë sekretariati po ashtu ka marr parasysht edhe mësimet nga zgjedhjet e kaluara kështu që synon disa pika ti përdor ato mjete që ka pasur efekte më të mëdha. Për shembull billbordet nuk kanë për të qenë sepse ato kanë pasur efekt të vogël nga aspekti i KQZ-s. Tash strategjia i ka mjaft disa për të mos hyrë në detale, por në KOZ në mënyrë unanime e ka aprovuar dhe rekomandon KQZ-n për aprovim.

Po ashtu, tha z. Rama, sot në mbledhjen e KOZ-it ka rekomanduar KQZ-n për bërjen e këshillit mbikëqyrës për informim publik, janë të gjithë personat e njëjtë që kanë marr pjesë në këshill për informim publik për zgjedhjet e Podujevës dhe Mitrovicës së Veriut por vetëm një zëvendësim ku në vend të Nenadit anëtarit të kaluar të jetë anëtare e re Gordana edhe rekomandon që tash Artani për shkak se në këshillin e kaluar kemi pasur një ndryshim të vogël që një anëtar i KQZ-s ka qenë kryesues i dy këshillave. Tash për ta krijuar atë barazi kemi rekomanduar Artanin që ta udhëheq këtë këshill sepse është i vetmi anëtar që nuk e udhëheq këshillin.

Valdete Daka: Nëse nuk ka dikush vërejtje, kush pajtohet që Artan Asllani të jetë kryesues i këshillit informues Arianit Elshani anëtar, Halim Rama anëtar, Gordana Zubinovic anëtare, Valmir Elezi anëtar dhe Vesa Xhara anëtare në sekretariat. Kush është për?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan Strategjisë së Informimit Publik për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe formimin e Këshillit Mbikëqyrës për Informim Publik

Valdete Daka: Faleminderit, vazhdojmë me pikën tjetër, shqyrtimi dhe miratimi i analizës dhe raportit me të gjeturat për identifikimin e mangësive dhe sfidave të trajnimit gjatë procesit zgjedhor 2009-2019.

4.Shqyrtimi dhe miratimi i Analizës dhe Raportit nga të gjeturat për identifikimin e mangësive dhe sfidave të trajnimit gjatë proceseve zgjedhore 2009-2019:

Alim Rama: Faleminderit. Këtë analizë këshilli për operacione zgjedhore e ka trajtuar vitin e kaluar por për shkak të festave të fund vitit nuk ka mbërritur në KQZ. Kjo analizë identifikon disa prej defekteve që kanë ndodhur në zgjedhjet e kaluara edhe ku njëra prej tyre është mos përgjegjësia direkte kush është përgjegjësi për trajnime. Ajo çështje që u ngrit edhe dje në takimin e KQZ-s, kështu që analiza jep disa rekomandime konkrete që të ketë një organo gram të qartë të përgjegjësive për trajnime.

Po ashtu, në bazë të analizave në faqen e fundit mundeni me pa disa anketime që ka mos qartësi kush është përgjegjës, ku është bërë një anketë me zyrtarët komunal të cilët ku prej 38 responentëve 22 kanë kërkuar të rikthehet praktika që ka qenë e mëhershme diku në 2016 ka qenë hera e fundit. Ku divizioni i trajnimeve është përgjegjës në mënyrë të plotësishtme për trajnime që të ketë një përgjegjësi edhe një adresë kush është fajtor.

Valdete Daka: Faleminderit. Kush është për aprovim? A ke diçka për të shtuar? Po urdhëro.

Sami Hamiti: Faleminderit kryetare. Është e vërtet që nevojitet një harmonizim mes divizionit për trajnim dhe pjesës së bartura që janë nëpër nivele sepse ka diskripancë. Ajo duhet të rregullohet dhe qartësohet po flas për fazat e para në fillim, pas këtyre zgjedhjeve të bëhet harmonizimi i rregulloreve dhe niveleve dhe rregullave dhe të ketë një adresë të qartë për këtë punë. Në parim, unë e përkrahi si analizë.

Alim Rama: Kisha një sqarim. Unë, nga përvoja ime me zgjedhjet në shumë shtete të ndryshme ku

trajnimet zakonisht janë të centralizuara edhe siç i kemi edhe në bazë të rregullores së KQZ-s. Sepse duhet ta dimë cili është personi përgjegjës për organizimin e trajnimeve. Ku koordinimi në teren përfshihet zakonisht në organizimin dhe koordinimin. Mbajtja dhe përgjegjësia për materialin duhet të jetë i centralizuar nuk është me rëndësi që anëtarët e këshillave të vendotimeve duhen të trajnohen njëjtë në secilën komunë për secilin vendvotim.

Arianit Elshani: E para, këtë analizë dhe raport e kemi trajtuar para shpalljes së zgjedhjeve dhe si të tillë nuk kemi pasur mundësi shumë që të diskutojmë dhe ti bëjmë ndryshimet qoftë ato që u përmendën nga z. Rama qoftë edhe ato që janë rekomandime brenda këtij raporti si të gjetura. Parimisht pajtohem se ka nevojë edhe ashtu siç e tha z. Amiti lidhur me një harmonizim me dy divizioneve dhe departamentit të terrenit dhe divizionit të trajnimit që të rregullojnë strukturën organizative dhe të kenë një organizim korrekt dhe konsistencë në lidhje me trajnerët.

Është çështje që realisht që të trajtohet pas zgjedhjeve që të jemi gati edhe për zgjedhje lokale të arrijmë të krijojmë një strukturë dhe të dimë qartazi se kush janë adresat dhe se kush mat performancën dhe ku jepet përgjegjësia dhe llogaria për punën e trajnerëve sepse kjo pastaj reflekton sigurisht edhe brenda gjithë procesit zgjedhor qoftë edhe tek komisionerët qoftë edhe tek vëzhguesit. Faleminderit.

Valdete Daka: Nëse nuk kemi diçka tjetër. Kush është për?

Anëtarët e KQZ-së, në fund, miratuan analizën dhe Raportin nga të gjeturat për identifikimin e mangësive dhe sfidave të trajnimit gjatë proceseve zgjedhore 2009-2019.

5.Shqyrtimi dhe i analizës dhe vlerësimit gjithëpërfshirës i Qendrave të Votimit

Alim Rama: Po ashtu, kjo analizë u bë para datës së zgjedhjeve, u trajtua në Këshill për Operacione Zgjedhore para vitit të ri. Sekretariati ka analizuar të gjitha qendrat e votimit dhe ka paraqitur disa rekomandime ku me qëllim që të afron sa më shumë votues në qendrën e votimit edhe që ti identifikoj ato qendra të votimit që i plotësojnë të gjitha kushtet posaçërisht një theksim ka qenë që të gjitha qendrat e votimit me pas pjerrinat për personat me aftësi të kufizuara dhe të ketë bashkëpunim sa më të ngushtë me instucionet e tjera shtetërore me komuna ose me ministrin e arsimit.

Po ashtu, tha mw tej Rama, është një prej rekomandimeve që të përdoren siç kanë qenë në analizën për votues që ka qenë vitin e kaluar që të përdoren sa më shumë shkollat fillore të cilat edhe ndodhen sa më afër qytetarëve mendoj që këto janë pikat kyçe të kësaj analize ku edhe është lista e të gjitha vendotimeve. Por po ashtu pas planit të rregullt sekretariati ka për obligim ti verifikoj të gjitha qendrat e votimit për zgjedhjet para se të aprovohet.

Valdete Daka: Faleminderit. Shpresoj që këto rekomandime do të futen tash edhe kur shqyrtohet numri dhe kur vlerësohen të gjitha qendrat e votimit.

Arianit Elshani: Po kryetare desha veçanërisht me këtë që e thatë edhe ju duke e ditur atë se çka është folur për zgjedhjet e kaluara. Në zgjedhjet e fundit që u mbajtën në Mitrovicën e Veriut dhe Podujevë realisht kërkoj nga ky departament që të merret edhe me qendrat e votimit pra që të arrij të qëndroj në kohë dhe ti sjell ato në KQZ për konfirmim para publikimit të qendrave të votimit pra që mos të krijohet një lëshim siç na ka ndodhur në të kaluarën. Faleminderit.

Alim Rama: Është edhe një diçka me rëndësi po ashtu me raport, rekomandohet që sekretariati dhe shkollat ta shfrytëzojnë sidomos katin e par për shkak të lehtësisë sepse praktika ka qenë të shfrytëzohen katet e dyta, kështu që tash kërkohet të shfrytëzohen katet e para që t'ju jepet mundësia të gjithëve sepse qasja me e lehtë.

Sami Hamiti: Kam pasur vërejtje. Në KOZ, kam kërkuar që të rishikohet komplet dokumenti si shkrim sepse tash, në anën tjetër po ju lus mos e publikoni në ueb-faqe të tillë pa e shikuar dikush. Të redaktohet është dobët e shkruar shqip. Gjysmë faqe as nuk ka tregues as nuk ka shenja pikësimi, unë e kam dhënë këtë vërejtje por po e shoh që nuk është përmirësuar, është mirë ta marr dikush ta lekturoj...

Valdete Daka: Mirë faleminderit. Me këtë rekomandimin e Samiut aprovohet. Shqyrtimi i planit të KQZ-s për adresimin e rekomandimeve nga misioni vëzhgues të zgjedhjeve të Bashkimit Evropian nga zgjedhjet e vitit 2019, pak me vonës por nuk e di sa kemi mundësi ta aplikojmë në këto zgjedhje.

6.Shqyrtimi i Planit të veprimit të KQZ-së për adresimin e rekomandimeve nga Misioni i Vëzhgueseve të Zgjedhjeve i Bashkimit Evropian nga zgjedhjet e vitit 2019

Alim Rama: Edhe ky rekomandim ka dalë para se të fillojnë zgjedhjet në KOZ para vitit të ri, para se të caktohet data e zgjedhjeve. Pak a shumë idetë që ne si KQZ sikurse instucionet e tjera nuk i kemi përmbushur rekomandimet e instucionit ndërkombëtar. Është faktik, këto janë rrethanat që veçse raporti që kemi trajtuar pak më herët për përfaqësimin e listave votuese. Pra të gjitha projektet e tjera nuk janë trajtuar edhe ato që kanë të bëjnë me rregulloret edhe me kuvendin.

Sami Hamiti: Është e vërtetë që e kemi trajtuar dhe në kuptimin e plotë shumica e këtyre rekomandimeve ndërlidhen me rekomandimin për zgjedhje kërkesën për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit që nënkupton reformën. Është e vërtetë edhe tek afatet, shikojeni tek afatet që nuk lidhet me ne thotë 48 orëshi jo po 96 orëshi, 96 orëshi në situatë të tillë çfarë jemi tash është i pa aplikueshëm sepse i ke 39 dit zgjedhje. Nuk varet nga KQZ-ja në pjesën e saj çka është KQZ-ja është e mira e të mirave kjo që është bërë pastrimi i listës, plus me këtë të dytën që morëm vendimin po them që ka për të pasur pastrim shumë më të madh të listës për herë të parë në një normë të tillë sepse viteve të tjera ke pasur pastrime 20.000, 30.000 por këtë vit duket që është trend më i mirë.

Pra, vlerwsoi z. Hamiti, është mirë që këto rekomandime që vijnë nga komisioni vëzhgues i BE-s në plotësi të zbatohen por në këtë vend e keni që shumica e tyre lidhen me ligjin për zgjedhje që edhe njëherë po e them ka nevojë imediate që të plotësohet dhe ndryshohet.

Alim Rama: Është një rekomandim që nuk është trajtuar nga KQZ-ja në përbërje të kaluar i cili është rekomandimi numër 6, të përmirësohet dizajni i fletëvotimit. Edhe pse ceket se organizatat jo qeveritare kanë propozuar diçka por aty ka pasur hapësirë që në vitin e kaluar të trajtoj mundësi të ndryshme.

Valdete Daka: E kemi shqyrtuar në përbërjen e kaluar edhe dizajnin edhe ndryshimin edhe përmirësimin po kemi ardhur në konstatim që megjithatë me këto rrethana edhe me këtë ligj më i thjeshtë nuk mund të bëhet as të ndryshohet sepse krijon huti edhe më të madhe. Kemi ardhur në përfundim, qe Samiu është një prej anëtarëve të vjetër. Kështu që e kemi trajtuar.

Alim Rama: Unë desha të lidhem në një send. Në analizën që e kemi trajtuar në vitin e kaluar për votat e pavlefshme ka pasur 50% të votave të pavlefshme janë për shkak të mos qartësi së votuesve që kanë për

obligim të votojnë për parti. Kështu që ndoshta edhe në informim publik si të votojnë për parti politike. Sepse vota për kandidat nuk vlen në coftë nuk votojnë për parti.

Eshref Vishaj: Desha të them se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përgjegjës vetëm për ato rekomandime që lidhen me instucionin ton pa e adresuar tek instucionet e tjera tek reformat zgjedhore që e përmendi edhe kolegu pak më herët. Për aq sa është e mundur këto rekomandime të zbatohen nga KQZ e të cilat nuk prekin reformën ose ligjin që nuk është përgjegjësi dhe kompetencë e jona.

Valdete Daka: Gjithsesi vetëm desha të shtoj që tek adresimi i këtyre rekomandimeve ne kemi pasur edhe gatishmërinë e OSBE-s që të na ndihmoj në lidhje me harmonizimin e rregulloreve me ndryshimin eventual të tyre. Pra kemi pasur gatishmëri, fatkeqësisht për shkak të pandemisë çështjeve nuk kemi mundur as ti adresojmë as ti realizojmë. Besoj që kjo gatishmëria e OSBE-s do të jetë edhe në këtë vit.

Burim Ahmetaj: Faleminderit kryetare. Faktikisht desha të ndërlidhem edhe këtu e kemi OSBE-n e cila zotohet se do të na ndihmoj në rekomandimet që do të adresohen nga ana e KQZ-s. Mirëpo desha të cekim se rekomandimi i 6 dhe 7 ndërlidhet me KQZ-n, mirëpo në të 6-tin shihet se nuk kemi progres mirëpo në rekomandimin e 7-të që është ekskluzivisht kompetencë e KQZ-s e kemi edhe pastrimin e listave nga pjesa e pensioneve. Tash e marrim edhe konfirmimin edhe nga zëdhënës kryeshefi ku i kemi diku 130.000 votues të cilët kanë dokumente të UNMIKUT. Kështu që besoj që në këtë rekomandim do të punojmë prapë edhe në mënyrë që ta kemi dhe pastrimin të listës përfundimtare të votuesve. Këto dy rekomandime që ndërlidhen direkt me kompetencën e KQZ-s. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka punuar mirë por tjerat janë në kompetencë dhe besoj që OSBE-ja siç e tha edhe znj. Daka do të na ndihmoj në këtë aspekt. Faleminderit.

Valdete Daka: Sa i përket pastrimit të listave unë mendoj që me këto dy çështje që i adresuam e kemi bukur një pastrim të mirë të listave sepse tash praktikisht na hiqen diku 150.000 qytetar të cilët praktikisht nuk kanë të drejtë vote dhe të cilët vetëm e kanë ngarkuar listën votuese dhe një numër i madh i tyre të cilët tash janë të ndjerë dhe me siguri që ne në mes të dy proceseve zgjedhore sepse ne shpejt do të jemi në prag të shpallës zgjedhjeve lokale edhe në mes të këtyre dy proceseve zgjedhore me siguri që do të vazhdojmë bashkëpunimin me ARC-n dhe me Ministrin e Punëve të Brendshme dhe do të vazhdojmë me eliminimin e personave të ndjerë nga lista votuese dhe pastrimin e tyre dhe praktikisht dhe mos harroni edhe personat të cilët e kanë humbur shtetësinë. Po urdhëro Eshref.

Eshref Vishaj: E kisha vetëm një kërkesë, aktivitetet e rregullta të cilat ndërlidhen me planin e punës me realizimin e planit të punës propozoj që të pezullohen përkohësisht deri sa të mbaroj procesi në mënyrë që të merremi më shumë me procesin zgjedhor e jo me aktivitetet të cilat ishte dashur që administrata ti përmbush në vitin që shkoj.

Valdete Daka: Praktikisht ato që nuk ndërlidhen me procesin zgjedhor pezullohen vetvetiu edhe pa marrë vendim. Por ne mundemi në mbledhjen e ardhshme ta marrim një vendim që të pezullohen aktivitetet që janë nga plani i punës. Unë vetëm kisha dashur ta di nga Burimi a kemi ndonjë aktivitet apo ndonjë afat nga plani operacional me qenë se nesër është vikend. Edhe a kemi ndonjë aktivitet i cili ndërlidhet direkt me planin operacional dhe na obligon gjatë ditës së nesërme të jeni ne këtu si anëtarë apo nuk ka çështje të cilat ne duhet patjetër të jemi këtu meqenëse jemi të gjithë. Ti njoftojmë.

Burim Ahmetaj: Aktualisht jemi konsultuar edhe me bartësin e monitorimit të planit operacional që është zëdhënës kryeshefi. Ku nuk ka ndonjë aktivitet që na duhet vendimmarrje përveç disa çështjeve administrative që janë në nivel të stafit, mirëpo jo i gjithë stafi vetëm një pjesë e stafit. Për ndryshe gjatë

këtij vikendi nuk kemi nevojë ndonjë vendimmarrje kështu që neve na mbetet të punojmë dhe ti respektojmë afatet. Kështu që nga fillimi i javës do të kemi agjendë.

Sami Kurteshi: Për shkak të kërkesës edhe të shoqërisë civile po e përmendi faktin që dokumentet e djeshme dhe sot e pat një lajm i cili realisht kishte gabuar edhe datat e votimit për diasporën dhe regjistrimit të diasporës. Kërkoj që dokumentet të publikohen në ueb-faqe ato të miratuar të djeshme të aktiviteteve nëse nuk janë publikuar në qoftëse janë publikuar kërkoj ndjesë për këtë kërkesë por keni parasysh që tash është një procedurë ku subjektet politike, shoqëri civile dhe qytetarët të jenë të saktë të informuar në lidhje me datat.

Valdete Daka: Kishte me qenë mirë që publiku dhe mediat ti referohen ueb-faqes ton sepse qarkullojnë lajme të ndryshme, data të ndryshme por edhe njëherë me qenëse ta sakta mediat sa i përket datave, afateve ti referohen ueb-faqes ton ku janë të publikuara me sa e di të gjitha afatet dhe plani operacional edhe zëdhënësit ton. A kemi diçka të shtojmë.

Sami Kurteshi: Kjo është e drejt edhe unë kam pyetje prej njerëzve të ndryshëm nga bota për çështje të ndryshme që realisht as unë vet nuk i di, nuk di të përgjigjem në to. A kemi ndonjë numër apo e-mail që njerëzit të drejtohen në KQZ për çfarëdo pyetje administrative, teknike që kanë edhe telefona edhe të gjitha. Unë nuk di të përgjigjem në të gjithë ato pyetje.

Burim Ahmetaj: E kemi e-mailin zyrtar i cili është info@kqz-ks.org, e-mail në të cilën adresohen të gjitha pyetjet dhe sigurisht që përgjegjës për kthimin e përgjigjeve është zëdhënësi kështu që kisha lutur të gjithë të drejtohen për gjithçka qoftë mediat qoftë palëve. Pastaj plasimin se për kë është pyetja e bën plasimin zëdhënësi, mirëpo përgjigjet, monitorimin sigurisht se do ti kemi përmes zëdhënësit për gjithçka. Por e kemi edhe numrin kontaktues edhe e-mailn zyrtar dhe sigurisht se do t`ju kthejmë përgjigje të gjithëve në ueb-faqe. Por për gjithçka le ti drejtohen mediat, zëdhënësit...

4.Të ndryshme.